

KRITERET PËR PJESËMARRJE, KUALIFIKIM DHE VLERËSIM TË OFERTËS

Autoriteti shitës kualifikon në procedurat e shitjes çdo kandidat ose ofertues vetëm kur paraqet:

- a) Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Biznesit
- b) Çertifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in
- c) Në rastin e personave fizik dokumenti original i identifikimit një kopje e të cilit do të depozitohet pranë komisionit të mbledhjes së ofertave publike.

Autoriteti shitës, kur kërkohet informacion për ofertuesin resident në një shtet të huaj, mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve përkatëse.

Skualifikimi i ofertuesve

1. Autoriteti shitës skualifikon në çdo kohë kandidatët ose ofertuesit, që paraqesin të dhëna të rreme ose një dokument të falsifikuar, për qëllime kualifikimi, gjatë një procedure shitje me mbledhje të ofertave publike. Autoriteti shitës në këtë rast vendos përjashtimin nga mbledhja e ofertave publike të ofertuesit që ka përdorur këto të dhëna apo dokumente.
2. Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.
3. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Për të vërtetuar se Kandidatët Blerës janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

Të gjithë dokumentat origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shpresa Breçani
Administratore Falimentimi
Nr. Lic 09

